BPrAL kolegji-heimerer

PrBHE college-heimerer

Nr. Prot: / Prot. No: 558/18 Data: / Date: 26/09/2018

Njësia: 1 Prishtinë

kolegji-heimerer

Arsim dhe Karrierë në Shendetësi

RREGULLORE E STUDIMEVE

Prishtinë 2018

Përmbajtja

Shkurtesat 3
RREGULLORE E STUDIMEVE BACHELOR DHE MASTER 4
I. Dispozitat e përgjithshme 4
Qëllimi i nxjerrjes së kësaj Rregullore 4
Format e punës së stafit Akademik 4
Fillimi i vitit akademik dhe Pranimi në studime dhe kushtet e regjistrimit 5
Për Studime Bachelor: 5
Për Studime Master 5
Regjistrimi i vitit pasues për studimet Bachelor dhe Master 6
Procedurat paraprake para nënshtrimit të provimit 6
Modalitetet e matjes së njohurive 7
Provimet dhe Afatet 7
Përjashtimet 8
Riprovimet 8
Vlerësimet 9
Komunikimi i rezultateve, konsultimet dhe refuzimi 9
Ankesat për vlerësim 9
Arkivimi 10
Procesi i Punimit të Temës së diplomës - Bachelor/Master 10
Procedura e Mbrojtjes së Punimit të Diplomës - Bachelor/Master 11
Procesi i Diplomimit 12
Lëshimi i Diplomës 12
Tërheqja e diplomës 12
Ceremonia e diplomimit 13
Përmirësimi i gabimeve në diploma 13
Të drejtat dhe detyrimet e studentit dhe mësimdhënësit 13
E drejta për ankesa 14
Detyrimet e studentëve: 14
Shkeljet etike dhe komisioni për çështje etike dhe disiplinore 14
Të drejtat e mësimdhënësve 15
Afatet e përfundimit të studimeve 15
Dispozitat kalimtare 15

Shkurtesat

BPrAL Kolegji Heimerer – Bartës Privat i Arsimit të Lartë Kolegji Heimerer

Bsc - Bachelor i shkencave

BA – Bachelor i arteve

Msc – Master i shkencave

SIMS – Sistemi i menaxhimit të Studentëve

ECTS – Europian Credit Transfer System

MASHT – Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë

Bazuar në Statutin e BPrAL Kolegji HEIMERER, Bordi Drejtues i Kolegjit në mbledhjen e mbajtur me datën: 26.09.2018, miraton këtë rregullore.

RREGULLORE E STUDIMEVE BACHELOR DHE MASTER

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Rregullorja për studime mbështetet në statutin e BPrAL Kolegji HEIMERER dhe derivon nga dispozitat e tij.

Neni 2

Kjo rregullore aplikohet për të gjitha programet studimore të Kolegjit HEIMERER, dhe si e tillë obligon të gjithë studentët, personelin akademik dhe administrativ në zbatimin e saj.

Neni 3
Qëllimi i nxjerrjes së kësaj Rregullore

a) Të përcaktojë formën e punës mësimore dhe shkencore;
b) Të përcaktojë kushtet që duhet të plotësohen për tu pranuar si student në studimet Bachelor dhe Master në Kolegjin Heimerer;
c) Të përcaktojë kushtet për regjistrimin e vitit;
d) Të përcaktojë kushtet që duhet të plotësojë studenti për t'iu nënshtruar provimit;
e) Të përcaktojë kushtet që duhet plotësuar studenti për t'iu nënshtruar riprovimeve;
f) Të përcaktojë formën e vlerësimit të studentëve;
g) Të përcaktojë rregulla të tjera që kanë të bëjnë me studentët (të drejtat dhe detyrimet e studentëve);
h) Të përcaktoj organizimin dhe rregullimin e studimeve themelore dhe ato më të larta.
i) Të përcaktoj kushtet dhe rregulloret e ndërrimit të programit të studimeve;
j) Të përcaktoj kohëzgjatjen e studimeve;
k) Të përcaktoj statusin e studentëve;
l) Të përcaktoj procedurat përkatëse të përfundimit të studimeve si dhe procesit të diplomimit;

Neni 4
Format e punës së stafit Akademik

a. BPrAL Kolegji Heimerer bazuar në Nenin 47 të statutit, përcakton format kryesore të punës mësimore dhe të suksesit të stafit akademik, këto forma janë: ligjëratat, praktika profesionale, seminaret, ushtrimet, testimet semestrale dhe gjysmë semestrale, prezantimet, provimet përfundimtare, observime, pjesëmarrja në projektet kërkimore e të tjera.

b. Ligjëratat si formë e punës mësimore, janë obligative për studentët. Specifikat e lëndëve përcaktojnë shkallën e detyrueshmërisë së vijimit të rregullt.

c. Mësimdhënësit në syllabusët e tyre përcaktojnë rregulloren e vijimit të ligjëratave, po ashtu paraqet programin e lëndës, dinamikën e realizimit të lëndës, metodat e punës, mënyrën e mbajtjes së provimit, literatura bazë dhe plotësuese, si dhe informata tjera.

d. Me miratimin e Prorektoratit për mësim dhe zyrës për Cilësi, mund të përcaktohen edhe forma të tjera të punës mësimore si dhe forma tjera të verifikimit të dijeve të fituara.

Neni 5
Fillimi i vitit akademik dhe Pranimi në studime dhe kushtet e regjistrimit

Viti akademik për studimet Bachelor dhe Master fillon prej muajit tetor dhe përfundon në muajin qershor.

Neni 6
Kushtet për pranim në studimet Bachelor dhe Master janë:

a) Të gjithë kandidatët të cilët kanë përfunduar me sukses shkollimin para universitar;
b) Për kandidatët të cilët kanë diplomuar nga viti 2008 e tutje, duhet të sjellin dëshminë relevante mbi përfundimin me sukses të provimit të maturës;
c) Të gjithë kandidatët të cilët kanë diplomuar në ndonjë shkollë të mesme të shteteve të tjera, duhet të paraqesin çertifikatat dhe diplomën për kryerjen e shkollimit 12-vjeçar që ju mundëson vazhdimin e arsimit të lartë. Së bashku me dokumentet gjegjëse këta kandidatë duhet të sjellin vendimin/çertifikatën për njohje të diplomës të lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës;

Neni 7
kushtet për pranim në studimet Bachelor janë:

Përfundimi i studimeve themelore, Bsc. ose BA si dhe rregullat tjera të përcaktuara nga MASHT;

a) Këshilli akademik nxjerr rregullore, të cilat përcaktojnë në hollësi kushtet dhe kriteret për regjistrim në studime themelore dhe atyre të avancuara.

b) Çdo student duhet të kalojë me sukses provimin pranues (apo format përkatëse testuese) për regjistrim në vitin e parë të studimeve.

c) Provimi pranues, respektivisht forma e testimit, hartohet për secilin program
d) dhe nivel te studimeve.

e) Bazura ne statutin e BPrAL Kolegji Hemierer, saktësisht bazuar në **Nenin 44**, numri i vendeve për studime përcaktohet nga Këshilli akademik sipas rekomandimeve te njësive akademike, për çdo vit të parë të studimit në secilën njësi akademike dhe në secilin nivel të studimeve (Bachelor, Master).

f) Bazuar në statutin e BPrAL Kolegji Heimerer Neni 45, rregullat për shpalljen e konkursit dhe për regjistrim nxirren nga Këshilli Akademik.

g) Statuti i Kolegjit Heimerer në Nenin 46, përcakton çështjen e kandidatëve të cilët nuk janë pranuar në vitin e parë të studimeve, sipas këtij neni kandidati/ja mund të ankohen kundër vendimit brenda tri ditëve të punës pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjes.

h) Kurse vendimi përfundimtar rreth ankesës merret nga komisioni 3 anëtarësh, i caktuar nga Bordi Drejtues.

Neni 8
Regjistrimi i vitit pasues për studimet Bachelor dhe Master

Studenti fiton të drejtën për regjistrimin e vitit vijues sipas rregullave të mëposhtme:

a. Studenti fiton të drejtën e regjistrimit të vitit të II (dytë) nëse nga viti i parë ka siguruar mbi 30 ECTS.

b. Fiton të drejtën e regjistrimit të vitit të III (tretë) nëse ka përfunduar të gjitha obligimet nga viti i I (parë) dhe ka siguruar minimum 30 ECTS nga viti i II.

c. Fiton të drejtën e regjistrimit të vitit të IV (katërt) nëse ka përfunduar të gjitha obligimet nga viti i I (parë) dhe i II (dytë) dhe ka siguruar minimum 24 ECTS nga viti i III (në programet 4 vjeçare).

Neni 9
Procedurat paraprake para nënshtrimit të provimit

a. Bazua në Nenin 51 të statutit të BPrAL Kolegjit Heimerer, studenti për t'ju nënshtruar provimeve në cilindo afat të provimeve është i obliguar t'i paraqesë provimet në SIMS brenda afatit të paraparë;

b. Në provim mund të hyjnë vetëm studentët të cilët janë në listën e studentëve dhe të cilët nuk kanë obligime ndaj institucionit;

c. Lista e shpallur e studentëve të cilët kanë të drejtë të hyjnë në provim duhet të përmbajë të dhënat e nevojshme rreth provimit, mësimdhënësit dhe studentëve;

d. Listat e studentëve që do të hynë në provime, publikohet së paku 3 ditë para datës së fillimit të afatit të provimeve;

e. Lista e studentëve mund të plotësohet dhe gjenerohet së paku deri 1 ditë para mbajtjes së provimit;

f. Në rastet kur studenti mungon ose tërhiqet nga provimi, në sistem evidentohet si abstenim.

g. Me kërkesë të studentit, mund të lejohet hyrja e tij në provim vetëm nëse dekani i njësisë akademike e miraton kërkesën e tij për të hyr më herët në provim. Kjo lejohet atëherë kur studenti është pjesë e programeve ndërkombëtare të shkëmbimit të studimeve, kur është duke vijuar mësimin praktik jashtë vendit.

Neni 10
Modalitetet e matjes së njohurive

a) Vlerësimi në lëndët mësimore përfshir edhe ato profesionale (provim ose kontroll semestral) bëhet në forma specifike.
b) Bazuar në Nenin 49 të Statutit të BPrAL Kolegji Heimerer, vlerësimi i njohurive të një lënde (provimi) mund të bëhet:
   - Me shkrim;
   - Me gojë;
   - Praktik;
   - I kombinuar, me shkrim e me gojë;
   - Përmes projekteve hulumtuese;
   - E të tjera;
c) Provimet vlerësohen nga një vlerësues ose nga një komision për provime.
d) Provimet mund të mbahen nga një komision për provime nëse:
   - Studenti është ankuar;
   - Apo kjo procedurë është caktuar me programin e studimeve.

e) Procedura e mbajtjes së provimit është e përcaktuar me rregullat e programit të studimeve.
   a) Mënyrat e vlerësimit të njohurive përcaktohen nga departamenti përkatës, mbështetur në planin mësimor.
   b) Përmbajtja e provimit, në të gjitha rastet e kontrollit, hartohen nga bartësi i lëndës së bashku me asistentin-en e tij (aty ku ka) dhe miratohet e nënshkruhet nga dekani.

Neni 11
Provimet dhe Afatet

a. Neni 49 i statutit të BPrAL Kolegji Heimerer, përcakton të drejtën e studentëve si dhe obligimin e tyre për të ju nënshtruar provimeve. Provimet organizohen për të gjitha lëndët, pas përfundimit të mësimit të paraparë me plan programin mësimor të lëndëve përkatëse. Studenti ka të drejt ti nënshtrohet provimit vetëm pasi ai plotëson kërkesat dhe detyrimet e lëndës përkatëse.

b. Studenti nuk ka të drejtë të paraqes dhe hyjë në provimet e vitit vijues pa përfunduar provimet e vitit paraprak (e njëjta vlen për çdo vit akademik).

c. Natyra, modaliteti i provimit si dhe modaliteti i vlerësimit të studentëve përcaktohet nga mësimdhënësi si dhe nga vetë karakteristikat e lëndës mësimore duke respektuar rregullat e vlerësimit sipas kritereve të përcaktuara në nenin 7 të kësaj rregullore, si dhe duke respektuat kriteret e përcaktuar nga vendimet e Këshillit Akademik për kriteret e kalueshmërisë. Megjithatë vlerësimi i suksesit akademik të studentëve mund të matet me metoda të ndryshme: testet semestrale dhe gjysmë semestrale, punimi, seminari, testi, testi praktik gjatë ushtrimeve.

d. Sipas nenit 50 të Statutit të Kolegjit Heimerer, studenti mund t'ju nënshtrohet provimeve në këto afate:

1. Afati i Janarit,
2. Afati i Prillit
3. Afati i Qershorit,
4. Afati i Shtatorit,

5. Afati pas ndjekjes së modulit [1]

Neni 12
Përjashtimet

Përjashtim i këtij orari janë vetëm modulet bllok, për të cilat organizohen afate të provimeve të veçanta.

a) Oraret e afateve të provimit shpallen në fillim të vitit akademik.
b) Oraret përcaktohen në mënyrën që studenti të mos ketë më shumë se një provim në ditë për lëndët e semestrit të fundit të përfunduar.
c) Pas shpalljes së orarit të provimeve, ky orar bëhet i obligueshëm dhe i detyrueshëm si për studentët ashtu edhe për mësimdhënësit.
d) Detajet e ndryshme rreth datës dhe kohës së fillimit dhe përfundimit të secilit afat të provimeve përcaktohet nga Këshilli Akademik.
e) Gjithashtu koha e paraqitjes së provimeve duhet të filloj jo më herët se 6 javë para përfundimit dhe jo më vonë se 8 ditë para fillimit të afatit të provimeve.
f) Provimet dhe riprovimet zhvillohen brenda afatit të caktuar në strukturën e vitit akademik, miratuar nga dekani. Datat e tyre shpallen jo më vonë se dy javë para fillimit të afatit.
g) Provimet nuk janë publike dhe pjesëmarrja e publikut nuk është e lejuar. Publiku mund të marrë pjesë vetëm në mbrojtjen publike të punimit të temës së diplomës (BSc dhe MSc).
h) Provimet zhvillohen në orën dhe datën e caktuar. Në rast pamundësie të zhvillimit të provimit ditën e caktuar, Dekani i programit, me urdhër me shkrim, e anulon atë dhe cakton një datë të mëvonshme, e cila u bëhet e njohur studentëve minimumi 48 orë para mbajtjes së provimit.
i) Studenti, në sistemin me ose pa shkëputje nga puna, nuk lejohet të hyjë për të dytën herë në provimin e një lënde, brenda një afati të provimit.
j) Studenti paraqitet në provim me dokument identifikimi me fotografi (indeks ose kartë identifikimi të Kolegjit HEIMERER).
k) Studentët që lëvizin në kuadrin e projekteve e programeve ndërkombëtare në të cilat merr pjesë institucioni, nuk kanë nevojë të dëshmojnë pjesëmarrjen në procesin mësimor. Nëse studentët kanë dhënë provimet jashtë shtetit dhe në institucione të tjera nga lëndët e ngjashme, ata duhet të parashtrojnë kërkesën tek zyra për njohje dhe barasvlerësim, pas aprovimit të kërkesës atyre u njihen ato provime dhe nuk kanë nevojë të paraqiten në ato provime.

Neni 13
Riprovimet

Procedurat e riprovimit janë si vijon:

a. Provimi nga e njëjta lëndë mund të përsëritet më së shumti 3 herë. Studenti i cili edhe herën e 3 nuk e kryen provimin, me kërkesën e tij, provimit mund t'i nënshtrohet para komisionit përkatës.

b. Nëse studenti nuk e kalon provimin edhe herën e 3, si dhe para komisionit, ai student detyrohet t'i përcjellë edhe njëherë ligjëratat dhe ushtrimet e lëndës përkatëse.

[1] Neni 53 i statutit te BPrAL Kolegji Hemirer

c. Në rast se studenti sërish e regjistron vitin e njëjtë, nuk merren parasysh numri i mëparshëm i provimeve të dështuara të studentit.

d. Në rast se sërish dështon katër herë në provim gjatë vitit të përsëritur, ai e humbet statusin e studentit të rregullt për llojin e studimeve përkatëse.

e. Nëse studenti edhe pas ri-regjistrimit të lëndës nuk e kryen provimin në mënyrën e përcaktuar në paragrafin e mësipërm, detyrohet të paguaj vetë profesorin e lëndës për afatet e tjera të provimeve. Profesori me kontrate nga institucioni është i detyruar ta mbaj provimin vetëm 3 (tre) herë.

Neni 14
Vlerësimet

Vlerësimet bëhen bazuar në dispozitat e nenit 48 të statutit të Kolegjit Heimerer, suksesi i studentëve në provime (apo lloje tjera të vlerësimit), vlerësohet me nota si vijon:

a. 10 (A) – (SHKËLQYESHËM, prej 91 deri 100 pikë);
b. 9 (B) – (SHUMË MIRË, me disa gabime, prej 81deri 90 pikë);
c. 8 (C) – (MIRË, me disa gabime që vërehen prej 71 deri 80 pikë);
d. 7 (D) – (KËNAQSHËM, me gabime domethënëse prej 61 deri 70 pikë);
e. 6 (E) – (MJAFTON, përmbushje e kritereve minimale, prej 51 deri 60 pikë);
f. 5 (F, FX) – (mos përmbushje të kritereve minimale, nën 51 pikë)

Provimi kalohet me sukses me notën 6-10.
Në format e verifikimit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultat i cili, detyrimisht, kthehet në notë.

Neni 15
Komunikimi i rezultateve, konsultimet dhe refuzimi

a. Komunikimi i rezultatit të provimit bëhet më së largu shtatë (7) ditë pas mbajtjes së provimit;

b. Komunikimi i rezultateve të provimit bëhet përmes vendosjes së rezultateve në sistemin e menaxhimit të studentëve (SIMS);

c. Konsultimet mund të kërkohen brenda afatit prej 2 ditëve pas publikimit të rezultateve në SIMS;

d. Kërkesa për konsultime bëhet përmes SIMS;

e. Refuzimi i notës mund të bëhet brenda afatit prej 2 ditëve të punës prej datës së komunikimit të rezultateve në SIMS;

f. Studenti është i obliguar që refuzimin e notës ta bëjë përmes SIMS, brenda afatit të paraparë në paragrafin e mësipërm,

g. Nota e përshkruar në raportin përfundimtar që dorëzohet në administratë, nuk mund të refuzohet dhe paraqet notën përfundimtare.

Neni 15
Ankesat për vlerësim

a) Studenti i pakënaqur me vlerësimin e profesorit, apo me rezultatet e publikuara, duhet që brenda dy ditëve të punës të paraqes ankesë më shkrim, gjegjësisht në programet përkatës përmes referentit-tës së programit. Ankesa duhet të jetë e arsyetuar.

b) Në bazë të arsyeshmërisë së ankesës, Dekani i programit vendos për emërimin e Komisionit tre anëtarësh për vlerësimin e studentit.
c) Kryetarin dhe dy anëtarë të Komisionit i emëron Dekanin me miratim nga Prorektorati për Mësim, në afat kohorë prej 72 orësh nga marrja e ankesës.
d) Njëri nga anëtarët e Komisionit duhet të jetë nga lënda tjetër e ngjashme, ndërsa pyetësi me notën e të cilit studenti nuk ka qenë i kënaqur nuk mund të jetë kryetar komisioni dhe nuk përcaktohet detyrimisht që ky të jetë anëtarë i komisionit (profesori i lëndës është pjesëmarrës pasiv në komisionin vlerësues).
e) Dekani i programit e cakton kohën e mbajtjes së provimit në afat prej katër ditësh nga paraqitja e kërkesës së studentit.
f) Komisioni merr vendim me shumicë votash. Vendimi i komisionit paraqet aktin përfundimtar kundër të cilit nuk mund të paraqitet ndonjë ankesë.
g) Rezultati i provimit shkruhet në një vendim të veçantë të Komisionit, të nënshkruar nga të tre anëtarët, i cili vendim duhet t'i bashkëngjitet procesverbalit të provimit nga e njëjta lëndë.

Neni 16
Arkivimi

a. Mësimdhënësi është i detyruar që në administratë (referentja e programit) të dorëzojë testet dhe procesverbalin e provimit (origjinal) të vërtetuar me nënshkrimin e tij, ndërsa tek ai mbetet kopja e procesverbalit të provimit.
b. Afati për dorëzimin e procesverbalit të provimit është maksimumi 14 ditë nga dita e mbajtjes së provimit.

Neni 17
Procesi i Punimit të Temës së diplomës - Bachelor/Master

a. Të gjitha programet e studimeve të BPrAL Kolegji Heimerer përfundojnë me punimin e temës Bachelor/Master.
b. Punimi i Diplomës është punë e pavarur e studentit (çdo herë në konsultime me mentorin), është një projekt hulumtues, inovacion apo studim i përgjithshëm, që lidhet me një disiplinë të vetme shkencore, apo edhe më shumë disiplina të përafërta (kur punimi është kompleks).
c. Punimi i diplomës identifikon tema përkatëse për fushën e studimeve, paraqet njohuri relevante në lidhje me temën, mund të zhvilloj një ose më shumë pyetje kërkimore, kërkon reflektim mbi tezën dhe sqarim për rëndësin e saj për profesionin përkatës.
d. Kandidati – ja gjatë procesit të punimit të temës së diplomës është i obliguar të zhvilloj konsulta me mentorin e temës. Konsultat bëhen me qëllim që të ipen dhe të merren këshilla profesionale akademike lidhur me formën e temës, përmbajtjen, dhe përfundimin.
e. Punimi i temës bëhet gjithmonë duke u bazuar në udhëzuesin për punimin e temës që përcaktohet nga BPrAL Kolegji Heimerer, që studentët mund ta marrin në zyrën për diploma dhe se konsiderohet shtojcë e kësaj rregullore.
f. Mentori i temës bënë evidentimin e të gjitha konsultave me kandidatin.
g. Pas përfundimit të të gjitha konsultimeve, dhe finalizimit të temës së diplomës, studenti është i obliguar që të dorëzojë (tre) kopje fizike dhe një kopje elektronike të punimit të diplomës, të lidhura në kopertina të forta, në zyrën e diplomave, dhe

këtë duhet ta bëjë së paku tri ditë para mbrojtjes së diplomës të cilat paraprakisht janë protokolluar në librin e diplomimit BPrAL Kolegji-Heimerer;

h. Dita për diplomim përcaktohet jo më vonë se 1 muaj, nga dita e dorëzimit të punimit të diplomës në administratën e BPrAL Kolegji-Heimerer, si dhe kjo datë përcaktohet nga Këshilli Akademik me kërkesën e zyrës së diplomave dhe Mentorit të temës në bashkëpunim me dekanin.

Neni 18
Procedura e Mbrojtjes së Punimit të Diplomës - Bachelor/Master

a. Pas dorëzimit të kopjeve fizike të diplomës (3 kopje fizike), Këshilli Akademik me vendim të posaqëm e emëron Komisionin përkatës për vlerësimin e temës;
b. Komisioni për vlerësimin e temës përbëhet nga tre anëtar.
c. Njëri nga antarët e komisionit duhet të jetë mentor i punimi të diplomës, po ashtu njëri nga antarët e komisionit (përveç mentorit të temës) duhet të jetë kryetar i komisionit;
d. Në periudhë kohore jo më të gjatë se një (1) muaj nga data e formimit të komisionit për vlerësim të temës nga Këshilli Akademik, komisioni duhet të takohet për vlerësim të temës;
e. Kryetari i Komisionit për vlerësimin e Temës Bachelor/Master, fillimisht konstaton se a janë plotësuar kriteret në bazë të kësaj rregulloreje, për vlerësimin e temës;
f. Mentori i Kandidatit e bën një prezantim të shkurtër të temës për vlerësim para komisionit, pastaj anëtarët e tjerë të komisionit e bëjnë vlerësimin individualisht dhe në fund merret vendimi i vlerësimit;
g. Në vendimin e vlerësimit caktohet edhe nota e punimit të Temës;
h. Për notimin e temës, komisioni merr për bazë formularin për vlerësim (shtojcë në këtë rregullore);
i. Notimi mund të bëhet sipas kritereve për vlerësim edhe në provime d.m.th. me notën: 6 (gjashtë), 7 (shtatë), 8 (tetë), 9 (nëntë), dhe 10 (dhjetë);
j. Kryetari i Komisionit, në prani të anëtarëve të tjerë të komisionit me miratimin edhe të anëtarëve tjerë, e vendos notën dhe e nënshkruan vendimin për diplomim të studentit;
k. Kandidati, që nuk arrin të plotësojë të gjitha kriteret për fillimin e procesit të diplomimit, por që është në proces të plotësimit të kritereve, mund të bëjë kërkesë për lejim të fillimit të procesit të diplomimit. Kërkesa shqyrtohet nga Këshilli Akademik, që pastaj jep vendimin për lejimin ose jo të fillimit të procesit të diplomimit për parashtruesin e kërkesës;
l. Studenti ka të drejt të ndërroj temën një herë, me këtë rast studenti obligohet të lajmëroj mentorin dhe shërbimin studentor, dhe pas kësaj në formularin e ndryshimit të temës ose mentorit shënohen detajet e ndryshimeve;
m. Tema e lejuar duhet të mbrohet me afat prej 12 muaj, nëse nuk arrihet ky afat atëherë tema e lejuar anulohet dhe studenti duhet te zgjedh temën e re.
n. Mbrojtja e temës është publike dhe caktohet në objektin e Kolegjit.
o. Pas paraqitjes me gojë, komisioni parashtron pyetje lidhur me temën, parimisht secili anëtar i komisionit parashtroj nga tre pyetje.
p. Pas parashtrimit të pyetjeve kryetari i komisionit mund të caktoj pushim për përgatitjen e përgjigjeve nga kandidati.

q. Nëse tema e diplomës është vlerësuar me notë të pamjaftueshme, atëherë kandidati duhet të plotësoj temën e diplomës dhe të eliminoj të metat e temës së diplomës, duke u bazuar në udhëzimet e kryetarit të komisionit dhe të vet komisionit. Dhe pastaj në afat 30 ditor përsëritet procedura e mbrojtjes së temës.

r. Studentit që i është vlerësuar tema e diplomës me notë të pamjaftueshme mund të ndërroj temën e diplomës dhe mentorin.

Neni 19
Procesi i Diplomimit

a. Në përfundim të studimeve, studentët që diplomojnë, fitojnë titullin përkatës profesional nga lëmi që ka studiuar;

b. Studenti temën e diplomës Bachelor mund ta paraqet me minus dy provime;

c. Tema Bachelor punohet nën mbikëqyrjen e Mentorit, i cili paraprakisht pranon të punojë me studentin;

d. Pas aprovimit të Temës nga Mentori, nënshkruhet vendimi nga Këshilli Akademik për aprovimin e temës, mentorit dhe komisionit vlerësues;

Mbrojtja e temës së Diplomës Bachelor/Master bëhet duke përmbushur hapat e mëposhtëm:

1. T'i kenë të përfunduara të gjitha modulet;
2. T'i kenë të përfunduara të gjitha obligimet kontraktuale;

Neni 20
Lëshimi i Diplomës

a. Studenti i cili e punon me sukses punimin e tij të Bachelor/Master dhe merr notën kaluese (6, 7, 8, 9 apo 10) konsiderohet i diplomuar.

b. I diplomuari duhet të pajiset me dokumentin përkatës - Diplomën si dhe me shtojcën e diplomës, sipas kritereve të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ Nr. 2/2012 të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe të Teknologjisë së Republikës së Kosovës.

c. Diploma i lëshohet të diplomuarit në afat prej 4 (katër) javësh, nga dita e Diplomimit.

d. Deri në lëshimin e diplomës, BPrAL Kolegji-Heimerer, do ti lëshojë të diplomuarit Çertifikatën e Diplomimit dhe pasqyrën e notave, në të cilën shënohen të gjitha lëndët me notat përkatëse dhe kreditë (ECTS);

e. Çertifikata e Diplomimit nënshkruhet nga Sekretari i përgjithshëm i BPrAL Kolegji-Heimerer;

f. Pasqyra e notave nënshkruhet nga Udhëheqësi i administratës i BPrAL Kolegji-Heimerer.

Neni 21
Tërheqja e diplomës

a. Tërheqja e diplomës bëhet personalisht nga i diplomuari, me nënshkrim dhe evidentohet në regjistrin përkatës.

b. Nëse prania e të diplomuarit është e pamundur, tërheqjen e diplomës mund ta bëjë ndonjë person i autorizuar me shkrim.

Neni 22
Ceremonia e diplomimit

Ceremonia për dorëzimin e diplomave, organizohet një herë në vit. Studentët që nuk mund të jenë prezentë në ceremoni, mund ta marrin diplomën më vonë personalisht.

Neni 23
Përmirësimi i gabimeve në diploma

a. Nëse diploma nuk është plotësuar në rregull, i interesuari duhet të mos e tërheqë atë dhe të kërkojë pajisjen me diplomë të rregullt.

b. Nëse i interesuari e tërheq diplomën e parregullt, apo në rast se i humbet ose dëmtohet origjinali duke iu bërë e papërdorshme, atëherë Kolegji Heiemrer mund të lëshoj diplomë duplikatë. Diploma duplikatë lëshohet sipas kushteve dhe procedurave në vijim:

1. Studenti duhet të shpallë të pavlefshme diplomën e humbur në njërën nga gazetat ditore në vend;
2. Ekstrakti nga gazeta ditore duhet të arkivohet në dosjen e studentit;
3. Diploma lëshohet më të dhënat e njëjta sikur diploma paraprake;
4. Në këndin e djathtë lartë shënohet shenja "DUPLIKAT", numri i protokollit dhe data e lëshimit (kjo mund të jetë edhe një vule që përmban këto të dhëna);
5. Të dhënat në diplomë përshkruhet dhe janë të njëjta me parapraken përveç shtimit të të dhënave nga pika e mësipërme.
6. Procedura dhe detajet tjera për lëshimin e diplomës mund të rregullohen me rregullore të veçantë.

Neni 24
Të drejtat dhe detyrimet e studentit dhe mësimdhënësit

Studenti ka të drejtë:

a) të marrë pjesë në ligjërata, seminare dhe aktivitete të tjera mësimore;
b) të përdorë të gjitha instalimet dhe pajisjet e Institucionit, sipas rregullave përkatëse, për të realizuar programin mësimor;
c) të përdorë bibliotekën, sallën e informatikës dhe mjetet tjera të institucionit;
d) të përfaqësohet në komisionet e institucionit në përputhje me Statutin dhe rregulloret përkatëse;
e) të organizohet në shoqata të ndryshme jopolitike në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse;
f) të ushtrojë të drejtën e tij për ankesë lidhur me procesin e mësimdhënies ose lidhur me lokalet ku mbahet mësimi.

Të drejtat tjera

a. Studenti me të përfunduar studimet ka të drejtë të bëjë përmirësimin e më së shumti dy notave.

b. Studenti duhet t'i parashtrojë kërkesë këshillit shkencorë-mësimorë përkatës për përmirësim e notës, kërkesa duhet të jetë e arsyetuar.

c. Pas aprovimit të kërkesës, studenti në afatin e rregullt vijues, mund t'i nënshtrohet provimit për ngritjen e notës nga lënda përkatëse.

d. Për përmirësim note studenti provohet vetëm një herë dhe mbetet në fuqi nota me të cilën studenti vlerësohet në fund.

Neni 25
E drejta për ankesa

a. Studenti apo studentët kanë të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit. Ankesa paraqitet në dekanat brenda 48 orëve nga momenti i përfundimit të provimit.

b. Përgjegjësi i programit, pasi verifikon shkeljet e reklamuar në bashkëpunim me komisionin për cilësi dhe Prorektoratin për mësim, merr vendim të formës së prerë.

c. Në rast se ankesa është e drejtë, vendoset anulimi i provimit brenda tri ditësh nga dita e ankesës dhe urdhëron përsëritjen e tij në një datë të veçantë brenda atij afati të provimeve.

Neni 26
Detyrimet e studentëve

a) Të njohë në hollësi të drejtat dhe detyrimet e tij dhe të jetë i vetëdijshëm për respektimin e tyre, në të kundërtën Institucioni nuk mban përgjegjësi për pasojat e mundshme si rezultat i mosnjohjes së tyre;
b) Të njohë dhe të zbatojë me përpikëri rregullat e mësimit dhe detyrimet e tij;
c) Të shlyejë të gjitha detyrimet e përcaktuara me planin mësimor dhe programet e lëndëve;
d) Të respektojë të drejtat e personelit të shkollës dhe të studentëve të tjerë;
e) Të ruaj prestigjin dhe dinjitetin e Institucionit;

Neni 27
Shkeljet etike dhe komisioni për çështje etike dhe disiplinore

a) Shkelje të rregullave të Kolegjit konsiderohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e studentit që cenojnë personalitetin e mësimdhënësit dhe të çdo punonjësi tjetër, normat etike – morale, si: kopjime në provime, falsifikimi i dokumenteve të ndryshme, aktet jo morale, vjedhja etj. Kur këto veprime nuk bartin elemente të veprës penale.

b) Ndaj studentit që kryen këto veprime, do të iniciohet procedura disiplinore në bazë të rregullores mbi procedurën disiplinore.

c) Masa më e lehtë disiplinore është vërejtja, kurse masa më e rëndë është përjashtimi i përhershëm.

d) Studentët të cilët nuk respektojnë: statutin, rregulloret e kolegjit, kodin e mirësjelljes, procedurat e mbajtjes së mësimit dhe provimeve dhe të tjera, shkelje këto të cilat raportohen nga studentët, stafi akademik dhe administrativ dhe informimi nëpërmjet formave të tjera. Komisioni për Çështje Etike dhe Disiplinore do të shqyrtojë dhe ndërmarrë masat konform rregullores.

Neni 28
Të drejtat dhe detyrimet e mësimdhënësve

Të drejtat dhe detyrimet e mësimdhënësit përcaktohen me kontratën e punës dhe me aktet e Institucionit.

Neni 29
Afatet e përfundimit të studimeve

a) Afati maksimal i përfundimit të studimeve të plota është deri në dyfishin e afatit të rregullt.

b) Studentët që nuk arrijnë të përfundojnë studimet brenda këtij afati, humbasin të drejtën e vazhdimit të studimeve.

c) Të drejtën e vazhdimit të studimeve e humbasin edhe studentët të cilët shpallen përsëritës të të njëjtit vit akademik dy herë.

d) Afati maksimal për mbrojtjen e temës së diplomës është deri në tri vjet në studime BScdhe 2 vjet në studimet MSc nga koha e përfundimit të studimeve.

Neni 30
Dispozitat kalimtare

Në rast se dispozitat e kësaj Rregulloreje bien në kundërshtim me dispozitat e Statutit të BPrAL Kolegji HEIMERER, përparësi kanë dispozitat e Statutit.

Neni 31

Kjo Rregullore hyn në fuqi më datën e miratimit nga Bordi Drejtues i Kolegjit Heimerer, ndersa aplikohimi do të bëhet me fillimin të vitit akademik 2018/2019.

Prishtinë 26.09.2018

Kryetari i Bordit Drejtues

BPrAL Kolegji Heimerer
Prishtinë
2010
PrBHE Heimerer College